


KURS TRAJNIMI MENAXHIMI I HUMBJEVE TË UJIT I & II

Përshkrimi i kursit

Volumi vjetor i humbjeve të ujit (uji pa të ardhura) në një sistem të furnizimit me ujë të pijshëm është një tregues i rëndësishëm si për efikasitetin e shpërndarjes së ujit, ashtu dhe për procedurat administrative të shoqërive ujësjellës kanalizime (UK). Humbjet e ujit janë një nga shkaqet kryesore të furnizimit me ndërprerje, dhe nën presionin e kërkuar të konsumatorëve. Mungesa e një furnizimi të vazhdueshëm, pa ndërprerje, e kombinuar me amortizimin e rrjetit, janë shkaqet për ndotjen e ujit të pijshëm.



Kontrulli i humbjeve të ujit, qoftë teknike ashtu dhe ato administrative, përbën një nga sfidat më të mëdha të Shoqërive UK. Menaxhimi i humbjeve

përmirëson cilësinë e shërbimit të furnizimit me ujë, dhe ndikon pozitivisht në qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë, duke ulur kostot e prodhimit dhe trajtimit të ujit.

Ky kurs do t'ju ofrojë pjesëmarrësve, njohuritë bazë të nevojshme për monitorimin dhe menaxhimin e humbjeve të ujit. Metodatat mbi auditin e ujit, menaxhimin e Zonave të Matura të Shërbimit (DMA) dhe menaxhimin e presionit, do të jenë disa nga temat kryesore që do të trajtohen gjatë dy ditëve të trajnimit.

Kush duhet të marrë pjesë

Ky kurs është hartuar për profesionistët e shoqërive ujësjellës kanalizime dhe është veçanërisht i vlefshëm për drejtorët e departamentit teknik dhe të shpërndarjes, kryeinxhinierët, inxhinierët e mirëmbajtjes dhe të shfrytëzimit, inxhinierët e matjes, teknikët e bilancit, si dhe menaxherët e faturimit dhe arkëtimit.


Kursi është me interes dhe për inxhinierë konsulentë, inxhinierë projektues, zyrtarë të shëndetit publik, apo institucione të tjera rregullatore dhe të ngjashme.

Objektivat e kursit të trajnimit

Në fund të këtij kursi trajnimit, ju do të jeni të aftë të:

- Identifikoni përfitimet e menaxhimit të humbjeve të ujit;
- Njihni metodat e procesit të auditimit;
- Shpjegoni elementët kryesorë të humbjeve administrative;
- Njihni strategjitë e menaxhimit të rrjedhjeve;
- Kuptoni rëndësinë e zonave të matura të shërbimit dhe të interpretoni rezultatet e tyre;
- Identifikoni treguesit e performancës për humbjet teknike dhe administrative;
- Identifikoni llojet e menaxhimit të presionit;
- Shpjegoni zbatimin e programit të monitorimit të presionit.

Metoda e trajnimit



Trajnimi është i bazuar në leksione të prezantuara në Power Point, të ndërthurura me diskutime dhe raste studimore. Përveç marrjes

së leksioneve dhe diskutimeve, pjesëmarrësit do të analizojnë raste konkrete duke u angazhuar në zhvillimin e ushtrimeve që përfshijnë përdorimin e të dhënave të shoqërisë së tyre.

Materialet e kursit

Si pjesëmarrës në këtë kurs, ju do të pajiseni me Manualin e Trajnimit për Menaxhimin e Humbjeve të Ujit I dhe II. Përpos kësaj, ju do të pajiseni me çertifikatë e cila dëshmon pjesëmarrjen tuaj në këtë trajnim.

Tarifa e regjistrimit

Anëtarët e SHUKALB - SHUKOS: 164 € ose 22.000 lekë për person.

Jo-anëtarët: 187 € ose 25.000 lekë për person.

Kjo tarifë përfshin materialet e kursit, drekat, dhe pushimet për kafe.